



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:022626
Datë: 25.02.2025
Numri i dokumentit: 06901151

C-IV.-14-4868

Ankuesi:

R B– Fshati B, Fushë Kosovë

Kundër

Pala

kundërshtare:

Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rruga “Dritan Hoxha”, Nr. 55, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtarja Hajrie Shala, me dt.25 shkurt 2025, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

- 1. Ankesa e ankuesit konsiderohet e tërhequr.**
- 2. Në këtë çështje nuk caktohen taksa gjyqësore.**

Rrethanat faktike dhe procedurale:

Me dt.20 qershor 2014, ankuesi kishte paraqitur ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, kundër të Vendimit të Autoritetit të Likuidimit nr.PRN093-0325 dt.04.06.2014 me të cilin i ishte refuzuar kërkesa për kompensim për mjetet e asistencës sociale në shumë prej 1.500,75€, për periudhë të pa caktuar, nga NSH “Gërmia”.

Me dt.14 nëntor 2024, gjykata lëshoi për ankuesin vërejtje për ta paguar taksën gjyqësore, duke e njoftuar se nëse taksat nuk paguhen brenda periudhës së caktuar prej 15 ditësh, ankesa do të konsiderohet e tërhequr. Vërejtja i ishte drejtuar ankuesit personalisht. Në të dy herët kur gjykata

kishte tentuar që të bëjë dorëzim – pranimin e vërejtjes me dt.13 nëntor 2024 dhe me dt.19 nëntor 2024 dhe zyrtari postës kishte konstatuar “adresa e pa mjaftueshme”.

Pas dështimit të dorëzimit – pranimin të dokumentit në bazë të nenit 26 par.5 të Ligjit nr.06/L-086 për DHPGJS, nenit 116 par.5 dhe nenit 116 par.6 të LPK-së, gjyqtari i DHPGJS urdhëron zyrën e regjistratit që të afishoj (publikoj) në Tabelën e Shpalljeve, Vërejtje për pagesën e taksave gjyqësore.

Kjo shpallje qëndroi në tabelë nga dt.29 nëntor 2024 deri me dt.09 dhjetor 2024.

Arsyetimi ligjor

Ankesa e ankueses konsiderohet e tërhequr.

Sipas nenit 76 par.3 i Ligjit Nr.06-L-086 Për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës parasheh: “Në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë *mutatis mutandis* dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore.”

Ankuesi konform dispozitës së nenit 253.4 të LPK-së *ka për detyrë që ankesës t’ia bashkëngjis vërtetimin mbi taksën gjyqësore të paguar.*

Në vazhdim dispozita 253.5 parasheh: “Në qoftë se paditësi nuk e paguan taksën gjyqësore të përcaktuar për padinë as pas vërejtjes së dërguar nga gjykata, edhe pse nuk ekzistojnë konditat për lirim nga detyrimi i pagimit të taksës gjyqësore, do të konsiderohet se padia është tërhequr.”

Me dt.14 nëntor 2024, gjykata përmes vërejtjes kërkoi nga ankuesja që të bëjë pagesën e taksës gjyqësore, duke e njoftuar se ankesa e saj do të konsiderohet e tërhequr nëse ai nuk e paguan taksën gjyqësore.

Ankuesit i është lejuar afati prej 15 ditësh që ta bëjë pagesën e taksës gjyqësore. Sipas vlerësimit të gjykatës, ky është një afat i mjaftueshëm kohor. Ankuesi ka për obligim të paguaj taksat gjyqësore. Taksat gjyqësore aplikohen sipas nenit 63 të Ligjit të Dhomës së Posaçme në lidhje me udhëzimin e KGJK-së nr. 01/2017, lidhur me taksat gjyqësore.

Pas dështimit të dorëzimit – pranimin, gjykata konform dispozitave ligjore, vërejtjen për pagimin e taksës gjyqësore e ka vendosur në tabelën e shpalljeve, nga dt. 29 nëntor 2024 deri me dt.09 dhjetor 2024 komunikimi i gjykatës me ankuesen, i kryer në këtë mënyrë konsiderohet i ligjshëm.

Sipas nenit 116 par.1 të LPK-së, pala ose përfaqësuesi i saj, në qoftë se gjatë zhvillimit të procedurës apo para se të kalojë afati prej gjashtë muajsh pas përfundimit të procedurës me vendim të formës së prerë, e ndërrojnë adresën në të cilën bëhet dorëzimi i shkresave kanë për detyrë që për këtë gjë ta njoftojnë menjëherë gjykatën, në rastin konkret gjykata ka tentuar ta

dorëzoj vërejtjen tek ankuesi ose përfaqësuesit e ankuesit ne adresën e dhënë nga vet ai, por nga konstatimi i zyrtarit te postes vërtetohet se adresa e ankuesit është jo e plotë .

Nga e gjithë kjo gjykata konsideron se ankuesi nuk ka interes për zgjidhjen çështjes së tij juridike për faktin se nuk e njoftoi gjykatën me adresën e plotë të tij dhe se në rastin konkret sipas dispozitave ligjore, ankesa konsiderohet e tërhequr.

Shpenzimet gjyqësore

Duke u bazuar në nenin 62 paragrafi 5 i Ligjit Nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, secila palë i bartë shpenzimet e veta.

Këshillë juridike

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 par.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

G j y q t a r j a
Hajrie Shala